

Gjykata e Apelit Korçë mbetet me 1 gjyqtar



Gjykata e Apelit Korçë ka mbetur me një gjyqtar pas shkarkimit të gjyqtarës Etleva Temo.

Sipas Euronews, kjo gjykatë ishte e përbërë me 3 gjyqtarë: Olsi Xhavella, Etleva Temo dhe Mimoza Margjeka.

Në detyrë është vetëm gjyqtari Xhavella pasi Margjeka është pezulluar nga detyra dhe gjendet në arrest shtëpie pas akuzave për korrupsion.

Gjyqtarja Temo u shkarkua ditën e sotme pasi KPK gjeti probleme me deklarinimin e pasurisë dhe profesionalizmin e gjyqtarës.